



Lidhja e kimistëve dhe teknologëve të Maqedonisë

Gara nga kimia për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme

SHIFRA:

(e vendos komisioni pas përfundimit të testimit këtu dhe në zarf)

PËR KOMISIONIN

Pikët e përgjithshme: _____

Kontrolloi (Emri Mbiemri): _____

RREGULLA PËR GARA REGJIONALE NGA KIMIA 2019

- 1) Gara fillon në **ora 10** dhe **zgjat 60 minuta**. Testet e dorëzuara pas kohës së paraparë nuk do të merren parasysh për kontrollim.
- 2) Testet janë të kapur së bashku me zarfet. Në çdonjërin zarf ka fletë në të cilën nxënësi i plotëson të dhënat e kërkuara: emri dhe mbiemri, shkolla, mentori dhe kështu me rradhë, ndërsa më pas e mbyll (e ngjit) zarfin.
- 3) **Nxënësi nuk guxon të vendos asnjë shenjë në test ose zarf.** Shifrën e testit e vendos komisioni ndër dhe mbi zarfin pas mbarimit të garës. Nëse vërehet ndonjë shenjë në test ose zarf, nxënësi do të diskualifikohet.
- 4) Garuesit janë të detyruar të mbajnë me vete stilograf kimik të kaltër. Testet zgjedhen duke përdorur stilograf kimik. **Nuk është e lejuar të punohet me laps.**
- 5) **Telefonat celular** duhet të lihen në katedër në fillim të garës dhe të mirren pas mbarimit të saj.
- 6) Për zgjidhje të testeve mund të përdoret kalkulator.
- 7) Është e ndaluar çfarëdolloj bisede në mes garuesve dhe përdorimi i teksteve shkollore, librave, fletoreve, letrave, sistemit periodik dhe ngjashëm. Të gjitha të dhënat e nevojshme janë të dhëna në test.
- 8) Pikët maksimale që mund të fitohen janë **50**.
- 9) Për përgjigje të saktë fitohen 2 pikë, ndërsa nëse përgjigja ngel e papërgjigjur ose gabimisht e përgjigjur (shlyerja e përgjigjeve ose rrethimi i më tepër përgjigjeve) nuk përfitohen pikë.
- 10) Nëse garuesi dëshiron të parashtrij pyetje, e thëret mësuesin përgjegjës (testatorin) në klasë, i cili e thëret koordinatori nëpërmjet telefonit celular. Koordinatori, në prani të edhe një mësuesi- mentori, vendos se a duhet t'i përgjigjet pyetjes së nxënësit. Pyetja duhet patjetër të parashtrihet heshtur, shkurt dhe qartë. Nëse që të dy mësuesit vendosin se pyetja meriton të përgjigje, koordinatori me zë e përsërit pyetjen dhe jep përgjigje të cilën duhet ta ndëgjojnë të gjithë nxënësit në klasë. Në të kundërtën, përsëri zëshëm, përgjigjet kështu për shembull: "Ajo nuk është e rëndësishme për garën".
- 11) Garuesi i cili nuk do t'u përmbahet ndonjëres (ose më tepër) prej rregullave/sugjerimeve, do të përjashtohet prej garës.



Përgjigjen jepe në atë mënyrë duke rrethuar një nga përgjigjet e dhëna. Çdo përgjigje e saktë sjell 2 pikë. Shkruaj me laps. Rrethimi i dy ose më shumë përgjigjeve ose rishkrimi i përgjigjes nuk merret parasysh (nuk rezulton në pikë).

TEST ME MË SHUMË PËRGJIGJE TË DHËNA, PREJ TË CILAVE VETËM NJËRA ËSHTË E SAKTË

(Përgjigjen jepeni duke rrethuar **vetëm një** prej opsioneve të dhëna A, B, C ose D)


1. Komponimi i parë organik i sintetizuar në laborator është:

- A. karbonat.
- B. karbamid.
- C. urina.
- D. uranati.

2. Atomi i karbonit në komponimet organike është:


- A. çdoherë dyvalent.
- B. Ndonjëherë dyvalent, ndonjëherë katërvalent.
- C. Çdoherë katërvalent.
- D. Ndonjëherë katërvalent, ndonjëherë trivalent.

3. Cila është ndërlidhja e këtyre dy komponimeve?



- A. Ata janë izomerë.
- B. Ata janë izobarë.
- C. Ata janë enantiomerë.
- D. Nuk kanë asnjë ndërlidhje.

4. Sa është numri i përgjithshëm (total) i lidhjeve σ në një molekulë të komponimit të dhënë në vijim?



- A. 6
- B. 10
- C. 11
- D. 12

5. Sa është numri i përgjithshëm (total) i lidhjeve π në një molekulë të komponimit të dhënë (në pyetjen 4)?

- A. 5
- B. 6
- C. 3
- D. 4

6. Numri i atomeve të karbonit me hibridizim sp^3 në një molekulë të komponimit nga pyetja 4 është:

- A. 1
- B. 2
- C. 3
- D. 4

7. Cili prej opsioneve të dhëna ka temperaturë më të lartë të vlimit!


- A. Propani.
- B. Acetoni.
- C. Metanali.
- D. Metanoli.

8. Sa izomerë hapësinorë ka heptini i padegëzuar?

- A. 5
- B. 2
- C. 3
- D. 4

9. Formula e lindanit është dhënë në vijim: Sipas kësaj formule, lindani është:

- A. Heksaklorlindan.
- B. heksaklorbenzen.
- C. heksaklorheksan.
- D. heksaklorocikloheksan.



10. Në 1 mol lindan:

- A. ka $6,022 \cdot 10^{23}$ atome hidrogjen.
- B. ka $12,044 \cdot 10^{23}$ atome hidrogjen.
- C. ka $36,132 \cdot 10^{23}$ atome hidrogjen.
- D. Nuk ka hidrogjen.

11. Reaksion pozitiv me ujë bromi (dmth çngjyrosja) do të rezultojë shtimi i:

- A. Benzenit.
- B. Metanolit.
- C. Cikloheksanit.
- D. Pentenit.



Përgjigjen jepe në atë mënyrë duke rrethuar një nga përgjigjet e dhëna. Çdo përgjigje e saktë sjell 2 pikë. Shkruaj me laps. Rrethimi i dy ose më shumë përgjigjeve ose rishkrimi i përgjigjes nuk merret parasysh (nuk rezulton në pikë).

12. Me nxehje të kujdesshme të etanolit me acid sulfurik të përqëndruar (mbi 170 °C, fitohet:

- A. Etani.
- B. Eteni.
- C. Etanali.
- D. Etini.

13. Cili prej opsioneve të dhëna në vijim NUK është komponim aromatik?

- A. Tolueni.
- B. Fenoli.
- C. Acetoni.
- D. Antraceni.

14. Cili prej opsioneve të dhëna nuk i takon këtij grupimi!

- A. Benzeni.
- B. Benzaldehidi.
- C. Etanali.
- D. Acetoni.

15. Formula molekulare e alkoolit monohidroksil me dy atome të karbonit është: :

- A. C₂H₄O
- B. C₂H₅O
- C. C₂H₆O
- D. C₂H₇O

16. Gjatë adiconimit të ujit në pent-1-en fitohet:

- A. Pentan.
- B. Pentanal.
- C. Pentan-1-ol.
- D. Pentan-2-ol.

17. Cila është formula molekulare e cikloalkanit me 14 atome të hidrogjenit?

- A. C₅H₁₄
- B. C₆H₁₄
- C. C₇H₁₄
- D. C₈H₁₄

18. Cili prej tretësve të dhënë në vijim është më polar?

- A. Heptan.
- B. Toluën.
- C. Etanol.
- D. Tetraklormetan.


19. Gjatë adiconimit të HBr në but-1-in në raport sasior 2 : 1, fitohet:

- A. 1,1-dibromobutan.
- B. 2,2-dibromobutan.
- C. 1,2-dibromobutan.
- D. 1,1,2,2-tetrabromobutan.

20. Dienët marrin pjesë në reaksione të:

- A. dehidratimit.
- B. polimerizimit.
- C. Substituimit elektrofil.
- D. Eliminimit të hidrogjenit.

21. Emri i komponimit të dhënë në vijim është:



- A. 4-metil-5-propilheptan-3,5-diol.
- B. 4-etil-5-metiloktan-4,6- diol.
- C. 5-etil-4- metiloktan -3,5- diol.
- D. Asnjëra nga tri opsionet e lartpërmendura.

22. Pjesëmarrja sasiore e karbonit në pyetjen paraprake është (përafërsisht):

- A. 15 %
- B. 20 %
- C. 30 %
- D. 40 %

23. Reaksion karakteristik i alkooleve është:

- A. Substituimi elektrofil.
- B. Substituimi nukleofil.
- C. Adicionimi nukleofil.
- D. Hidratimi.

24. Propan-1,2,3-triol është i njohur me emrin:

- A. Etilen glikol.
- B. Glirecol.
- C. Fenol.
- D. Aldol.

25. Izomerë funksional janë:

- A. Acetoni dhe acetaldehidi.
- B. Propanon dhe propanol.
- C. Propanon dhe propanal.
- D. Propen dhe propin.